

Për: "Marketing&Distribution" sh.p.k dhe "Trimed" sh.p.k adresa: Tiranë, Kashar, Autostrada, Tiranë-Durrës, Kilometri-10.

Procedura e konçesionit/partneritetit publik privat

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Paketa e kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e grupmoshës 40-65 vjeç do të përfshijë këta komponentë:

a) Vlerësim, këshillim, trajtim dhe ndjekje për faktorët e stilit të jetesës:

i) Puna që kryen apo ka kryer;

ii) Ushqyerja;

iii) Konsumimi i duhanit;

iv) Konsumimi i alkoolit;

v) Niveli i stresit dhe depresionit.

b) Matje, vlerësim, këshillim, referim dhe ndjekje e parametrave fiziologjikë:

i) Tensioni arterial;

ii) Peshë trupore;

iii) Aktiviteti i zemrës.

c) Matje, vlerësim, këshillim, trajtim, referim dhe ndjekje e parametrave biokimikë:

i) Formula e gjakut;

ii) Hb, HCT, MCV, MCH, MCHC;

iii) Kolesterol total, HDL kolesterol, LDL kolesterol, trigliceride;

iv) Glicemia;

v) Feçe për gjak okult;

vi) Albuminuria, prania e qelizave, cilindrave, kristaleve në urinë;

vii) Bilirubinë totale dhe direkte, transaminaza (SGPT, SGOT).

1. Forma e kontratës: **Konçesioni i shërbimeve publike.**

2. Burimi i financimit: **Spektori privat**

II.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja e kontratës se konçesionit do të jetë 10 vjet.

Publikime të mëparshme: **nuk ka pasur**, Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedure këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Genius sh.p.k Vlera (me numra dhe fjalë) **nuk ka**

2. Natural Pharma Europe Vlera (me numra dhe fjalë) **nuk ka**

3. Pegasus sh.p.k Vlera (me numra dhe fjalë) **nuk ka**

4. Marketing & Distribution Vlera (me numra dhe fjalë) 730.075.000 lekë (shtatëqind e tridhjetë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë)

5. Proton Vlera (me numra dhe fjalë) 617,025,000 lekë (gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë milion e njëzet e pesë mijë).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Genius sh.p.k

2. Natural Pharma Europe

3. Pegasus sh.p.k

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Mungesë dokumentacioni

Ministria e Shëndetësisë lajmëron operatorin "Marketing&Distribution" sh.p.k dhe "Trimed" sh.p.k adresa: Tiranë, Kashar, Autostrada, Tiranë-Durrës, Kilometri-10 se oferta e paraqitur më datë 11.09.2014 për marrjen me koncesion **për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 40-65 vjeç** është pranuar.

Afati i negocimit të Kontratës tuaj do të jetë: 10 ditë

Afati i negocimit mund të zgjatet nga Komisioni i Dhënies së Konçesionit.

Ofertuesi *Marketing & Distribution" sh.p.k dhe "Trimed" sh.p.k* kërkohet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues dokumentet e mëposhtme:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Konçesionare\Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.
- Sigurimin e Kontratës sipas formës së kërkuar në Dokumentet Standarde të Procedurës Konkurruese. Sigurimi duhet të paraqitet jo më vonë se në momentin e nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.
- Dokument bankar që vërteton pagesën e kryer për shpenzimet e publikimit dhe shpenzimet e konsulencës së specializuar (*në rast se ka*). Kjo pagesë do të kryhet para fillimit të negociatave.
- Në rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.10.2014

Ankesa: ka ose jo: **jo nuk ka pasur.**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë